



FORUM SHKENCOR

“TRANSFORMIMI DIXHITAL”



- **8:30 – REGJISTRIMI**

Moderator: Prof. Dr. Genti GUXHO

- **9:00 – 9:20** – MSc. Rixin QOSHJA (I ftuar, GIZ Advisor – Sustainable Urban Transport in Albania) - *Dixhitalizimi i transportit publik dhe roli i open data për zhvillim të qëndrueshëm.*

SESIONI I – “DIXHITALIZIMI I SIPËRMARRJES & INDUSTRIË”

- **9:20 – 11:00**

1. MSc. Armand AGOLLI - *Dixhitalizimi i Arkivave Audio Vizuale (Case Study - Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave).*
2. Prof. Asoc. Eralda XHAFKA – *Transformimi dixhital i shërbimeve publike – Zhvillimet kryesore në administrimin e shërbimeve publike.*
3. Prof. Asoc. Tatjana SPAHIU – *Transformimi dixhital në kompanitë e veshjeve dhe këpucëve në Shqipëri*
4. Prof. Asoc. Ilo BODI – *Cilësia e produkteve të prodhuara me printer 3D*
5. Msc. Kriselda GURA - *Inovacioni teknologjik i hapur në modelin e ekonomisë qarkulluese për ruajtjen e burimeve dhe krijimin e vlerës*

- **11:00 – 11:30 – PUSHIM KAFE**

SESIONIN II – “DIXHITALIZIMI I EDUKIMIT”

- **11:30 – 13:30**

1. Prof. Asoc. Valma PRIFTI - *Gatishmëria e Arsimit Dixhital në fushën e Arsimit të Lartë.*
2. Prof. Asoc. Erald PIPERI – *Dixhitalizimi i objekteve kulturore nëpërmjet teknikave të avancuara 3 dimensionale.*
3. Dr. Elda DOLLIJA, - *Si po riformëson teknologjia modelet e punës dhe biznesit.*
4. MSc. Edlir SPAHO - *Përdorimi i Inteligjencës Artificiale për Personalizimin e Kurseve Online.*

- **13:30 – 14:30 PUSHIM DREKE**

Sponsor:



Ky forum shkencor do të organizohet si bashkëpunim i **Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike**, Universiteti Politeknik dhe **Universitetit Beder**, në kuadër të **Ditës Botërore të Telekomunikacionit** e cila ka filluar të festohet çdo vit më 17 maj, që nga viti 1969, për të theksuar ndikimin transformues që teknologjia ka ndikuar në të gjitha aspektet e jetës sonë.

Këtë vit fokus ynë është Dixhitalizimi i Sipërmarrjes & Industrisë dhe Dixhitalizimi i Edukimit, duke sjellë së bashku drejtues të industrisë, akademikë dhe studentë për të diskutuar mundësitë dhe sfidat që na ka ofruar dixhitalizimi, si dhe për të shkëmbyer ide dhe për të krijuar ura bashkëpunimi.

Panelistët do të ndajnë ekspertizën e tyre mbi trendet më të fundit në teknologji, ndërsa studentët do të kenë mundësinë të inspirohen për detyrat dhe projektet inovative që mund të realizojnë në të ardhmen e afërt, duke ditur se ku mund të drejtohen për të marrë këshilla nga profesionistët më të mirë të fushës. Tashmë për Industrinë 4.0 transformimi dixhital është kyç për konkurrueshmërinë dhe inovacionin. Kompanitë po adoptojnë inteligjencën artificiale, analizën e të dhënave dhe automatizimin për të përmirësuar efikasitetin dhe për të krijuar produkte dhe shërbime më të personalizuar.

Ky event gjithashtu do të ofrojë një platformë për ekspertët e industrisë për të ndarë me studentët përvojat dhe praktikat më të mira për implementimin efektiv të teknologjisë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Duke qenë se edukimi është një shtyllë e rëndësishme e transformimit dixhital, ku mësimi online, platformat interaktive, inteligjenca artificiale dhe realiteti virtual po revolucionarizojnë mënyrën e të nxënës.

Universitetet po përshtaten me këto ndryshime, duke përfshirë teknologjitë më të fundit në kurikulat e tyre. Në këtë kuadër, diskutimet do të fokusohen në rëndësinë e një bashkëpunimi më të ngushtë mes akademisë dhe industrisë për të siguruar që studentët të jenë të përgatitur për tregun dinamik të punës. Transformimi dixhital nuk është vetëm një domosdoshmëri, por edhe një mundësi për të ndërtuar një të ardhme më inovatore dhe të qëndrueshme. Duke bashkuar industrinë, universitetin dhe studentët, ne mund të krijojmë një ekosistem ku inovacioni dhe zhvillimi ecin paralelisht.

DATA 13 MAJ 2025

SALLA AULA MAGNA – UPT